

TË DREJTAT E NJERIUT NË ISLAM¹

Shejh Abd el-Aziz Ibn Abdullah Al el-Shejh²
[Kryemyftiu i Mbretërisë së Arabisë Saudite]

O robër të Allahut!, Allahu krijoi jetën dhe tërë gjithësinë për një qëllim madhështor dhe për një urtësi absolute, e tërë këtë nuk e bëri kot e kot. Allahu thotë:

“Vallë, a nuk mendojnë ata në vetvete? Allahu ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe ato që gjenden në mes tyre - vetëm me qëllim dhe afat të caktuar.” (Kuran, 30:8)

dhe:

“Mos vallë keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t’ju gjykuar)?!” (Kuran, 23:115)

Pastaj Allahu përmend fjalët e besimtarëve që i thonë në lutjet e tyre:

“O Zoti Ynë!, Ti nuk i ke krijuar kot këto – I lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.” (Kuran, 3:191)

Këtë krijim (krijimin e qenieve njerëzore) e bëri më madhështorin dhe më të shkëlqyeshmin nga të gjitha krijesat tjera që i krijoi. Ai e krijoi njeriun në formën dhe pamjen më të mirë. Allahu e pajisi njeriun me intelekt me të cilin ai dallon- nëpërmjet udhëzimit të Allahut- të vërtetën prej të pavërtetës, udhëzimin prej devijimit, të mirën prej të keqes, dobinë prej dëmit.

“Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit: ua kemi bërë të mundur që të udhëtojnë në tokë dhe në det, u kemi dhënë ushqime të mira e të lejuara dhe i kemi ngritur lart mbi shumë prej atyre që kemi krijuar.” (Kuran, 17:70)

Prej nderimit është ajo se Allahu krijoi të atin tonë, Ademin, me Dorën e Tij, fryu në të jetën prej shpirtit të Tij e, më pas, engjëjt iu përulën në sexhde atij.

¹ **Shënim i përkthyesit në anglisht:** Ky fjalim është marrë pjesërisht nga autori gjatë ligjëratës të së Premtes.
² Shejh Abd el-Aziz Ibn Abdullah Al el-Shejh. Aktualisht është kryemyfti, autoriteti më i lartë fetar në Arabinë Saudite. U lind në vitin 1941 (e.r.). Mësimin përmendesh të tërë Kuranit e arriti kur ishte në moshën dymbëdhjetë vjeçare. Më pas, u caktua si anëtar i Këshillit të Lartë të Dijetarëve në vitin 1986 (e.r.) për tu bërë anëtar i Komitetit të Përhershëm për Studime Islame dhe Verdikte Fetare. Pastaj u emërua si zëvendës i kryemyftiut të atëhershëm Shejh Abd el Aziz Ibn Baz (vdiq 1420 p.h.) në vitin 1995 (e.r.). Përpos postit të kryemyftiut dhe punës në daua (përhapjen e Islamit), merë pjesë edhe në programin e radios islamike “Nur ala el-Darb”, mban fjalime dhe ligjërata në qytetet e Rijadit dhe Taifit.

“Ç’të pengoi ty që të mos përuleshe në sexhde para atij që e kam krijuar Vetë me Duart e Mia?” (Kuran, 38:75)

Allahu ia mësoi Ademit emrat e të gjitha gjësendeve dhe e bëri atë mëkëmbës në tokë

“Unë do të krijoj një mëkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në tokë” (Kuran, 2:30)

dhe ia nënshtroi tërë universin atij

“Ai ka vënë në shërbimin tuaj çka gjendet në qiej dhe në Tokë, të gjitha janë prej Tij.” (Kuran, 45:13).

Nga gjiri i llojit njerëzor nxori të Dërguarit dhe Profetët që i dërgoi për ta udhëzuar njerëzimin në rrugë të drejtë, qoftë në këtë botë, qoftë në botën e amshueshme. Pa dyshim, Islami merret me qeniet njerëzore deri në shkallën më të lartë. Prandaj, ligjet e parapara në Sheriat të Allahut kanë ardhur për t’i pastruar robërit (qeniet njerëzore) dhe atyre t’u sjellin suksese në të dy botët. Që këtej, veprat e adhurimeve nuk janë tjetër pos ngritje e cilësive shpirtërore, pastrime shpirtërore, edukim i shpirtit në mënyrën më të përsosur dhe ngritje kah idealet më të larta. Kështu, falja e pesë kohëve të namazit njeriun e largon nga imoraliteti dhe veprat e tjera të shëmtuara:

“Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar.” (Kuran, 29:45)

Falja e namazit është lidhje e robit me Zotin e tij, është adhurim përmes së cilit Allahu ia shlyen mëkatet atij. Profeti, sal-lallahu alejhi ue selem, ka thënë:

**“Çka mendoni, sikur të ishte një lum para derës së ndonjërit prej jush, në të cilin do të lahej për çdo ditë nga pesë herë? A do të mbetej në të ndyrësi?”
Thanë: “Nuk do të mbetej kurrfarë ndyrësie”. I Dërguari tha: “Ky është shembulli i pesë kohëve të namazit. All-llahu me faljen e namazeve i shlyen mëkatet.”³**

Çfarë është agjërimi në muajin Ramadan përveçse shtytje në *takua* (frikë-respekt ndaj Allahut) dhe nxitje në durim, vepër që kultivon ndjenjën e përgjegjësisë.

Po Zekati (lëmosha e detyrueshme)? Nuk është gjë pos pastrim për shpirtin, rritje dhe shtim i pasurisë, i cili u jepet vëllezërve nevojtarë.

Po çfarë është Haxhi (pelegrinazhi)? Është një konferencë e madhe islamike, në të cilën marrin pjesë muslimanët, të cilët nga kjo konferencë përfitojnë duke përforcuar kështu

³ E shënojnë Muslimi (nr. 1071), el-Tirmidhiu (nr. 2794), el-Nesai (nr. 458) dhe Ahmedi në *el-Musned* (nr. 8569), nga hadithi i Ebu Hurejres (radiallahu anhu).

vëllazërinë e tyre dhe bashkimin e umetit islam. Kurani i drejtohet njerëzimit dhe i urdhëron ata që të meditojnë rreth krijësive të Allahut:

“O ti njeri, po ç’ të mashtroi ty kundrejt Zotit tënd që është bujar e i urtë? Ai të krijoi, të përsosi, të drejtoi e të formoi në formën që Ai dëshiroi!” (Kuran, 82:6-7)

Kurani, po ashtu, i drejtohet njerëzimit, në mënyrë që atyre t’ua sqarojë përfundimin e tyre, duke ua bërë me dije se fundi i tyre është tek Allahu:

“Atëherë, ti, o njeri, që përpiqesh shumë, mundin tënd do ta gjesh te Zoti yt.” (Kuran, 84:6)

Çlirimi nga lloji më i rëndë i robërisë

Prej qëllimit më madhështor të Islamit është ajo se kjo fe i garantoi njerëzimit të drejtat e tyre si nder dhe begati që Allahu ua dhuroi atyre. Begatia më e madhe e Allahut ndaj njeriut është se Islami e çliroi atë nga robëria, poshtërimi dhe shirku⁴. Për shirkun (shoqërimi i partnerëve Allahut në adhurim) Allahu ka thënë:

“Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe.” (Kuran, 31:13)

Vetë shirku është robëri, për shkak se mushriku (ai që bën shirk) është adhurues i tjetërkujt përveç Allahut. Ai veten e tij e përkuh dhe e robëron ndaj tjetërkujt përveç Allahut. Prandaj, Islami erdhi për ta ftuar njerëzimin të adhurojë vetëm Allahun dhe e tërë feja të bëhet me sinqeritet vetëm për Allahun. Islami i thërret njerëzit që zemrat e tyre t’i lidhin tek Allahu me dashuri, me frikë dhe me shpresë. Shirku e robëron dhe e poshtëron personin si dhe ata të cilët thërrasin që, krahas Allahut, të adhurohet edhe dikush tjetër, duke besuar se këta idhuj kontrollojnë çështjet e tyre. Por, e vërteta është se këta idhuj kanë vënë mur mes atyre dhe Allahut, duke i devijuar ata nga rruga e Allahut. Allahu i Lartësuar ka urdhëruar që përujja dhe nënshtrimi të bëhen vetëm ndaj Tij. Përujjen tonë dhe nënshtrimin duhet bërë vetëm ndaj Allahut, pa ndërmjetës mes nesh dhe Zotit tonë, si gjatë lutjeve apo shtresimit:

“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thujtu se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua.” (Kuran, 2:186)

“Zoti juaj ka thënë: “Lutmëni Mua, do t’ju përgjigjem!” (Kuran, 40:60).

⁴ **Shënim i përkthyesit në anglisht:** Shejh Salih Ibn Sad el-Suhejmi – hafidhullah - thotë:

“Shirk do të thotë të vendosësh dikë përveç Allahut në nivel të njëjtë me Të, ani pse kjo e drejtë i takon vetëm Allahut. Do të thotë, t’i drejtohem i lloje të ndryshme të adhurimeve dikujt tjetër përveç Allahut.” Referoju *Mudhekereh fi el-Akideh* (fq. 30) të Salih el-Suhejmit.

Thirrësit për në idhujtari i kanë larguar njerëzit nga Zoti i tyre, duke i ftuar ata që të mbështeten tek shpirtrat e të vdekurve, atyre që nuk janë të pranishëm, tek ata që nuk janë në gjendje t'i dëgjojnë lutjet e tyre e lëre me t'iu përgjigjen nevojave të tyre. Ata ftojnë njerëzit në rrugët e devijuara të sufive. Kështu, këta thirrës i devijuan njerëzit nga rruga e Zotit të tyre duke pretenduar se nuk ka shteg tjetër që çon tek Allahu pos rrugës së tyre të devijuar (sufive). Prej kujdesit të Islamit është se kjo fe nuk e ngarkon njeriun me mëkatet apo me gabimet e tjetrit përderisa ky njeri nuk është shkaktar i mëkatit apo gabimit. Allahu thotë:

“Kushdo që bën diçka, punon për vete dhe askush nuk ngarkohet me barrën e tjetrit.” (Kuran, 6:164).

Barazia në Islam

Prej kujdesit të Islamit ndaj njerëzimit është ajo se, para Sheriatit të Allahut, të gjithë njerëzit kanë të drejta të barabarta me vëllezërit e tyre nga lloji njerëzor, në kuptimin e përgjithshëm:

“O njerëz!, në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin.” (Kuran, 49:13)

Njerëzit dallojnë nga njëri-tjetri për nga niveli i imanit (besimit). Njerëzit më të mirë janë besimtarët, kurse më të këqijtë janë jobesimtarët. Njerëzit e imanit (besimit) pastaj dallojnë nga njëri-tjetri për nga niveli i *takua* (frikë-respektit ndaj Allahut), disa prej tyre kanë më shumë *takua* sesa të tjerët.

“Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij.” (Kuran, 49:13)

Siguria personale në Islam

Islami ia ndaloi njerëzimit zullumin. Kjo fe i dhuroi njeriut të drejtën për të jetuar dhe ia garantoj këtë të drejtë. Askujt nuk i lejohet t'ia marrë jetën tjetrit. Kjo e drejtë i takon vetëm Atij që ia dhuroi këtë jetë (Allahut), e Ai është i Plotfuqishëm mbi çdo gjë. Allahu e ka bërë haram të derdhet gjaku i qenieve njerëzore. Ai thotë:

“Kushdo që vret një besimtar me qëllim, ndëshkimi i tij është Xhehenemi, në të cilin do të qëndrojë përgjithmonë. Allahu është zemëruar me atë, e ka mallkuar dhe i ka përgatitur një dënim të madh.” (Kuran, 4:93)

“Mos i vrisni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë! Ne u sigurojmë ushqim atyre dhe juve.” (Kuran, 17:31)

Dhe ka thënë:

“Mos ia merrni tjetrit jetën të cilën Allahu e ka shenjtëruar, përveçse kur e kërkon drejtësia (ligji).” (Kuran, 6:151)

Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ue selem, thotë në një hadith:

“Me të vërtetë, gjaku i juaj, pasuria dhe nderi janë të ndaluara për njëri tjetrin.”⁵

Në një hadith tjetër, thuhet:

“Robi do të vazhdojë të ngrihet në fe përderisa nuk derdh gjakun që është i ndaluar.”⁶

Dhe në një hadith tjetër, thuhet:

“Çdo mëkat mund të shlyhet nga Allahu, përveç njeriut që vdes si mushrik (politeist), apo njeriu që e vret besimtarin padrejtësisht.”⁷

Veç këtyre, në një hadith tjetër, thuhet:

“Sikur të gjithë njerëzit në qiej e në tokë të bashkoheshin për ta vrarë një musliman padrejtësisht, Allahu do t’i hidhte të gjitha ata me fytyra në Zjarr të Xhehennemit.”⁸

Të drejtat e grave

Prej kujdesit të Islamit është ajo se kjo fe e ka vlerësuar lart gruan dhe i kushtoi asaj rëndësi të veçantë. Islami qëndron mes dy poleve të kundërta, teprimit dhe neglizhencës. Islami e ka çliruar gruan prej atyre që dëshirojnë ta shtypin atë duke ia mohuar të drejtat e saj, dhe prej atyre që përpiqen ta privojnë atë nga feja dhe nderi. Kjo fe gruas ia siguroi nderin dhe fisnikërinë. Islami e çmon gruan si nënë, si bashkëshorte, si vajzë e si motër. Islami ia mbron asaj trupin nga shikimet e atyre që s’i ka të afërm dhe

⁵ E shënojnë Buhariu (nr. 1623), Muslimi (nr. 3180), Ibn Maxheh (nr. 3046), el-Tirmidhiu (nr. 2085), el-Darimi në *el-Sunen* (nr. 1836) dhe Ahmedi në *el-Musned* (nr. 18198).

⁶ E shënojnë el-Buhariu (nr. 6355), Ebu Davudi (nr. 3724), dhe Ahmedi në *el-Musned* (nr. 5423).

⁷ *Sahih*, e shënojnë Ebu Davudi (nr. 3724), el-Nesai (nr. 3919) dhe Ahmedi në *el-Musned* (nr. 16302). Ky hadith është vlerësuar si autentik nga el-Albani në *Sahih el-Xhami* (nr. 4524).

⁸ Referoju *Kanz el-Umal* (nr. 45993) të el-Hindit.

ka caktuar *mahrem*⁹ për të, që të merret me çështjet e saj. Islami ia ndaloi mashkullit që s'është i afërm i saj të vetmohet me të, dhe asaj ia ndaloi që të përzihet me gjininë e kundërt. Krejt kjo për t'ia mbrojtur asaj nderin dhe fisnikërinë, për shkak se gruaja është ajo që mbjell farën e parë të edukimit dhe përparimit të shoqërisë. Islami i dha asaj të drejtën e trashëgimisë dhe të arsimimit. Gjithashtu, kjo fe i dha asaj të drejtën që të martohet me pëlqimin e saj. Prandaj, ajo ka të drejtë ta refuzojë ose ta pranojë propozimin për martesë. E tëra është nga kujdesi që Islami tregon për gruan. E ky kujdes, pa dyshim, nuk buron nga ata që bëjnë zhurmë për të drejtat e saj, duke u munduar kështu ta prishin karakterin, natyrën dhe bujarinë e saj. Këtë e bëjnë me qëllim që gruan ta shndërrojnë në objekt të kënaqësive të tyre, objekt që bie ne duart e meshkujve të cilët luajnë me të ashtu siç dëshirojnë ata. Ata (ata të cilët trumbetojnë feminizmin) nuk çajnë kokën për nderin e saj, për fenë e saj dhe për çiltërsinë e saj.

Të drejtat e familjes

Islami i kushtoi kujdes të madh dhe garantoi të drejtat e familjes. Prindërve u dha të drejta. Bashkëshortit i dha të drejtat e tij. Bashkëshortes të drejtat e saj. Dhe fëmijëve të drejtat e tyre. Në Islam edhe fqinjët kanë të drejta. Po ashtu, Islami përkujdeset edhe për fqinjët, për të afërmit dhe për shokët e ngushtë. Kjo fe na obligoi t'i ruajmë marrëdhëniet farefisnore dhe ta mbajmë shoqërinë e unifikuar nëpërmjet imanit (besimit) -

*“Muslimani është vëlla i muslimanit. Ai nuk e shtyp atë, nuk e gënjen, nuk e përbuzë. Gjaku, pasuria dhe nderi i muslimanit i janë të ndaluara muslimanit.”*¹⁰

Të drejtat e njeriut burojnë nga Islami

Në të vërtetë, zanafillën e të drejtave të njeriut e gjejmë tek akideja (kredoja) e shëndoshë, e cila ka ardhur me të vërtetën dhe drejtësinë:

“Ne i çuam të dërguarit Tanë me prova të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librat (e shenjtë) dhe peshoren (e drejtësisë): që njerëzit të veprojnë drejt.”
(Kuran, 57:25)

Këto janë të drejtat e njeriut në Islam, të drejtat e vërteta, e jo si ato që pretendohen nga ata njerëz që kanë shkuar në ekstrem sa i përket të drejtave të njeriut. Ata shkelin qeniet

⁹ Shejhul Islami, Abd el-Aziz Ibn Baz (vdiq 1420 p.h.) ka thënë:

“Mahremi është personi që e ka të ndaluar martesën me një femër, për shkak të lidhjeve të gjakut, siç janë p.sh. babai ose vëllai. Ose mahremi në bazë të martesës, siç është bashkëshorti, babai i bashkëshortit ose i biri i tij. Ose mahremi në bazë të gji-dhënies (babai ose i biri i gruas që u ka dhënë gji) etj.” Referoju *Mexhmu el-Fetava ue Mekalat el-Mutanavieh* (8/336) të Ibn Bazit.

¹⁰ E shënojnë el-Buhariu (nr. 6437), Muslimi (nr. 4677), Ebu Davudi (nr. 4248), el-Tirmidhiu (nr. 1850) dhe Ahmedi në *el-Musned* (nr. 7402).

njerëzore në emër të të drejtave të njeriut. Të drejtat e mirëfillta të njeriut burojnë nga Islami, sepse kjo fe mbron natyrën shpirtërore të njeriut, intelektin e tij, trupin dhe mendjen e tij, deri në maksimum. Këtë realitet nuk mund ta gjesht tek ata që çirren duke u thirrur në të drejtat e njeriut, ndërsa e vërteta është se këta njerëz janë gënjeshtarë tiranikë.

Qenieve njerëzore këto të drejta nuk ia dhuroi vetë njeriu, por ato janë prej dhuntive të Allahut. Në Islam ka të drejta të cilat njerëzit në përgjithësi i gëzojnë, të drejta që i përkasin politikës, ekonomisë, arsimimit dhe të drejtave shoqërore. Këto të drejta janë të garantuara me Islam dhe nuk u nënshtrohen ndryshimeve, për shkak se dalin nga vetë Sheriati Islam.

Mos ua vëni veshin atyre që thërrasin në të drejtat e njeriut! Realiteti tregon se këta njerëz shtypin dhe trajtojnë shumë keq njerëzit e tjerë. Ata janë të mëshirshëm ndaj kriminelëve, duke i anashkuar krimet e tyre në emër të të drejtave të njeriut. Me këtë, këta njerëz morën barrën e bashkëfajësisë në miratimin e shtypjes dhe padrejtësisë në emër të të drejtave të njeriut. Pra, të drejtat e mirëfillta të njeriut përfshihen në Sheriatin islamik të drejtë dhe të paanshëm, i cili është sistemi i fundit i të gjitha ligjeve tjera të shpallura, siç thotë Allahu:

“Ne nuk kemi harruar asgjë në Librin Tonë.” (Kuran, 6:38)

“Të përkryera janë fjalët e Zotit tënd në vërtetësi dhe drejtësi. Fjalët e Tij askush nuk mund t’i ndryshojë. Ai dëgjon çdo gjë dhe di çdo gjë.” (Kuran, 6:115)

Pretendime boshe për të drejtat e njeriut

Këto janë të drejtat e vërteta të njeriut. Ato i gjejmë në Islam. Ato burojnë nga akideja (kredoja) e rrënjësuar thellë e që jetësohen nëpërmjet imanit (besimit). Këto të drejta përmbajnë kufijtë më të lartë të drejtësisë dhe paanshmërisë. Të drejtat e njeriut nuk janë shkak për shkatërrimin dhe prishjen e virtyteve. Të drejtat e njeriut nuk burojnë nga shthurja morale dhe agnosticizmi në emër të lirisë, e as nga ata njerëz që përpiqen t’i eliminojnë dallimet natyrore të gjinive, me të cilat ka ardhur Sheriati i Muhamedit, në mënyrë që ta degjenerojnë gruan muslimane, t’ia prishin asaj modestinë dhe karakterin.

Nuk bën që të drejtat e njeriut të bëhen shkak që dënimet shariatike të konsiderohen si të papërshtatshme për këtë kohë, të pamëshirshme dhe barbare. Nëse hajduti na vjedh, ndihemi të lënduar sikurse ndihemi të lënduar nga shthurja e të pamoralshmit, por nuk guxojmë që ta kapim të paturpshmin, gënjeshtarin dhe të pamoralshmin. Në këtë rast, të drejtat e njeriut të kësaj natyre janë shtypje dhe padrejtësi. Të drejtat e mirëfillta të njeriut janë vetëm ato me të cilat ka ardhur sheriati i Muhamedit. Sa sisteme ligjore bëjnë

bujë për të drejtat e njeriut dhe thërrasin në to, siç pretendojnë ata, ndërkohë vetë ata kanë mospajtime rreth çështjeve të tyre.

Ku janë të drejtat e njeriut, kur përdoren armë shkatërruese? Ku janë të drejtat e njeriut, kur bombardohen njerëz brenda ndërtesave? Ku janë të drejtat e njeriut, kur hedhen në ajër xhamitë dhe shkollat Islamike? Ku janë të drejtat e njeriut, kur dikush përçan dhe prish popujt? Ku janë të drejtat e njeriut, kur dikush pushton të dobëtit, i poshtëron dhe i privon ata nga liritë e tyre? Të drejtat e njeriut këtu janë vetëm në letër dhe traktate, të cilat më pas hedhen në shportën e mbeturinave. Prandaj, të drejtat e vërteta të njeriut janë ato të cilat i ka sjell Muhamed Ibn Abdullahu, sal-lallahu alejhi ue selem.

O ju njerëz!, me të vërtetë, Zoti i juaj është një dhe i ati juaj është një (Ademi). Joarabi nuk është më i mirë se arabi e as arabi më i mirë se joarabi. Nuk ka përparësi i ziu ndaj të bardhit, e as i bardhi ndaj të ziut, përveç se në *takua* (frikë-respekt ndaj Allahut). Feja Islame i mbron njëmend të drejtat e njeriut, madje, në të gjitha sferat e jetës, ndonëse pushtuesit dhe tiranët e akuzojnë Islamin për çdo të keqe. Kjo, për shkak se ata kanë zemra të sëmura dhe të devijuara. Ata nuk e besojnë Kuranin dhe Sunetin (Traditën e Profetit Muhmed). Sikur muslimanët t'i qaseshin me kujdes Librit të Allahut dhe Sunetit të Profetit të Tij, pa dyshim, do ta kuptonin se e vërteta dhe drejtësia gjenden në këto dy burime, gjithherë dhe përgjithmonë.

Përktheu nga anglishtja: Visar Zeka